



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:244070

Datë: 06.02.2024

Numri i dokumentit: 05293067

**2023:257830**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti I Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit Q.L nga Hani Elezit, i akuzuar për veprën penale, Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par. 8 lidhur me par.6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1456/23 të datës 15.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.01.02.2024, në prezencë të prokurores së shtetit, Mimoza Syla-Hyseni, të dëmtuarit Q.L dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av.H.L, me dt.06.02.2024 mori dhe shpalli,dhe të njëjtën datë përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

I pandehuri Q.L nga Hani Elezit, ndërtesa afër Postës kati i II-të, i lindur më dt...., nga i ati I... dhe e ëma E..., e gjinisë Th..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i 3 fëmijëve, të kryer shkollën fillore, punëtor sezonal në ndërtimtari, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:...

## ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 06 Korrik 2023 rreth orës 18:17 min, në fshatin Laq, Komuna e Hani Elezit, duke drejtuar automjetin transportues të markës “...” ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit ..., në kundërshtim me dispozitat e nenit 48,53 dhe 65 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor Nr.05/L-088, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke mos e përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës e cila ka qenë me kthesa të njëpasnjëshme, dhe duke mos e mbajtur mjaftueshën anën e djathtë të rrugës dhe distancë të mjaftueshme anësore gjatë përballëkalimit, në momentin që ka hy në kthesë në anën e majtë, duke qenë në shiritin e kahjes së kundërt, me pjesën e parme të majtë të këtij automjeti e godet në pjesën e parme të majtë automjetin e markës “... ngjyrë e kaltërt, me targa ..., të cilin e ka drejtuar i dëmtuari Q.L, i cili ka qenë duke lëvizur në kahje të kundërt, në raport me të pandehurin. Si pasojë e këtij aksidenti përveq dëmit material në vlerë të papërcaktuar, i dëmtuari Q.L, ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,44,69,70,71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

## **G J Y K O N**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim konfor nenit 44 të KPRK-së, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 500.00 € .

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t’a paguajë në afatin prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe ate në dy këste mujore.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t’a zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 20.00€, në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 170.00€, ndërsa për

Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjyben, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuara Q.L, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1456/23 të datës 15.11.2023 të pandehur Q.L nga Hani Elezit, e ka akuzuar për veprën penale, Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Në bazë të kësaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.01.02.2024 me të cilin rast, prokurorja e shtetit Mimoza Syla-Hyseni, mbeti në tërësi pranë aktakuzës të parashtruar pranë kësaj gjykate, pa ndryshime dhe plotësime.

I dëmtuari në fjalën e tij në pyetjen e gjyqtarës deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale të prokurorisë, ndërsa kërkesën pasurore juridike do ta realizoj pranë kompanisë së sigurimit të automjetit të pandehurit.

I pandehuri në fjalën e tij në pyetjen e gjyqtarës e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, dhe shton se, pavarësisht faktit që aksidenti ka ndodhur pa dashjen e tij, I vjen keq për dëmin e shkaktuar të dëmtuarit, me të cilin nuk kanë patur ndonjë problem pas aksidentit, meqë edhe janë kusheri dhe takohen mes veti, dhe duke I premtuar gjykatës se në të ardhmen do të jetë shumë më I kujdesshëm në komunikacion për të mos u përsëritur raste të tilla, njëherit I kërkon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit, ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim sa më I ulët që të jetë e mundur.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i akuzuar për veprën penale, Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së,, pasi që një pranim i tillë u bë vullnetarisht nga ana e të pandehurit si dhe është në përputhje me dispozitën e nenit 242 të KPP-së, andaj i propozon gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë për të pandehurin dhe t'i shqiptojë sanksion penal sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij deklaroi se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, prandaj edhe kërkon nga gjykata që ky pranim i fajësisë të aprovohet nga gjykata, me që i njëjti është bërë komfor dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së .

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, prandaj edhe pranoi pranimin e fajësisë për të pandehurin.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e shqyrtimit fillestar, duke shprehur keqardhje për veprimin e tij, dhe duke premtuar para gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm në komunikacion për të mos u përsëritur raste të tilla, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti se, bazuar në evidencën e kësaj gjykate, raporti I së cilës është bashkangjitur shkresave të lëndës, I njëjti evidentohet edhe për raste të tjera penale, për të cilat është gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm, ndër to edhe për veprë penale të kësaj natyre, ndërsa rrethanë tjetër të posaçme rënduese gjykata nuk gjeti, përveq veprimeve të të pandehurit të cilat paraqesin elemente të veprës penale, për të cilën shpallur fajtor,

Andaj gjykata, për këto arsye të pandehurin Q.L, i akuzuar për veprën penale, Rrezikim i Trafikut Publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale duke

ngritur vetëdijësimin për respektimin e ligjit dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 462 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**2023: 257830 datë 06.02.2024**

Sekretarja Juridike,  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.